

RAPORTI VJETOR

2018-2019

Tiranë, dhjetor 2019



RAPORTI VJETOR PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019

Pasqyra e lëndës:

1. Realizimi i misionit të arsimit të lartë	2
2. Realizimi vjetor i objektivave të institucionit	4
3. Të dhëna të përgjithshme mbi institucionin	6
4. Relacion në lidhje me plotësimin e standardeve shtetërore	35
5. Financimi dhe Menaxhimi i Burimeve.....	94
6. Fushata e marketingut.....	95
7. Vlerësime të institucionit mbi MASR dhe rekomandime	96

1. REALIZIMI I MISIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

Misioni i Universitetit “EPOKA”, i cili nisi veprimtarinë në vitin akademik 2007-2008, konsiston në:

- të qenit një institucion mësimor-kërkimor inovativ dhe me ndikim, në shërbim të vlerave njerëzore thelbësore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të dijeve në nivel ndërkombëtar;
- rritja e individëve me ndjeshmëri shoqërore, të mirëkualifikuar, produktivë, profesionalë dhe të përgjegjshëm, me shpirt të orientuar drejt kërkimit dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe
- dhënia e kontributit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës së shoqërisë mbështetur në nevojat kombëtare dhe rajonale.

Misioni i sipërpërmendur është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, të shprehur në nenin 1 të Ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me standardet ndërkombëtare si dhe me veçantitë dhe risitë që synon të sjellë ky institucion i arsimit të lartë në vendin tonë dhe më gjerë.

Në funksion të realizimit të këtij misioni dhe të rolit që institucionet e arsimit të lartë në tërësi duhet të luajnë në dobi të shoqërisë ku zhvillojnë aktivitetin e tyre, Universiteti “EPOKA”, gjatë vitit akademik 2018-2019, zhvilloi aktivitete të shumëllojshme në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe të kontributit për shoqërinë.

Universiteti zhvilloi aktivitetin e tij të mësimdhënies cilësore në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve në tre Fakultete: Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative si dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përkatësisht në këto fusha: Arkitekturë, Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Kompjuterike, Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital, Ekonomiks, Financë-Bankë, Informatikë Ekonomike, Administrim Biznesi, Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik, Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Drejtësi si dhe Studime Evropiane. Në këtë kuadër, në përfundim të këtij viti akademik, u diplomua edhe brezi i tetë i studentëve në programet e studimit të ofruara nga ana e Universitetit.

Gjithashtu, gjatë këtij viti akademik, në Universitetin “EPOKA” vazhduan veprimtarinë programet e studimit të ciklit të tretë të Doktoraturës, në këto fusha: Arkitekturë, Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Kompjuterike, Ekonomiks, Administrim Biznesi si dhe Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Gjatë vitit akademik 2018-2019, u publikuan në total 39 artikuj shkencorë.

Në kuadër të kontributit për shoqërinë, u realizua këshillim karriere për maturantët e shkollave të mesme në të gjithë vendin, u ofruan bursa të shumta për maturantët më të suksesshëm si dhe u organizuan veprimtari të klubeve studentore në ndihmë të shtresave në nevojë.

Për sa i përket kontributit që çdo Universitet duhet të japë për zhvillimin e vendit, u zhvilluan me sukses 19 programe Master dhe 6 programe të Doktoratës, ku u paraqitën 95 teza të Masterit të Shkencave mbi një gamë të gjerë sektorësh dhe çështjesh të ndryshme që prekin Shqipërinë, duke dhënë në këtë mënyrë një kontribut të rëndësishëm në fondin e literaturës që ekziston rreth tregut shqiptar.

Gjatë vitit akademik 2018-2019, Universiteti “EPOKA” vijoi t’i kushtonte një rëndësi të veçantë aktiviteteve jashtë-kurrikulare të studentëve, nëpërmjet aktivizimit të tyre në veprimtari sociale, kulturore dhe sportive nëpërmjet klubeve studentore, organizimit të praktikave të punës në institucione publike dhe kompani private brenda dhe jashtë vendit, planifikimit të karrierës etj.

Në kuadër të aktiviteteve jashtë-kurrikulare, gjatë këtij viti akademik, u organizua në mjediset e kampusit universitar Panairi i gjashtë i karrierës, i cili u përqëndrua në informimin me mundësitë e punësimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë të 419 studentëve që ndiqnin studimet në programe të ndryshme studimi dhe ishin në prag diplomimi.

2. REALIZIMI VJETOR I OBJEKTIVAVE TË INSTITUCIONIT

Gjatë vitit akademik 2018-2019, Universiteti “EPOKA” përmbushi synimet e planifikuara në lidhje me procesin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit ndaj shoqërisë.

Në lidhje me procesin mësimdhënës, një vëmendje e veçantë iu kushtua përqendrimit të mësimdhënies tek rezultatet e të nxënit (learning outcomes) si dhe matjes të këtyre rezultateve. Në fund të çdo semestri, pedagogët iu nënshtruan vlerësimit nga ana e studentëve në lidhje me të gjithë parametrat e procesit të mësimdhënies dhe rezultatet e këtij vlerësimi u përdorën nga ana e autoriteteve drejtuese për të planifikuar stafin akademik për semestrin pasardhës si dhe nga ana e pedagogëve për të përmirësuar ato pika të theksuara nga ana e studentëve. Procesi mësimdhënës në të gjitha ciklet e studimit u krye në mjediset e kampusit universitar në Rinas, i cili përmban të gjithë infrastrukturën e nevojshme fizike dhe teknologjike për një zhvillim të procesit mësimor në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, duke mundësuar veçanërisht mbështetjen e vazhdueshme të procesit mësimdhënies në përdorimin e teknologjisë së informacionit.

Për sa i përket procesit të kërkimit shkencor, Universiteti “EPOKA” vijoi të mbështeste financiarisht publikimin e librave dhe të artikujve shkencorë si dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit. Në këtë kuadër, gjatë vitit akademik 2018-2019, u publikuan në total 39 artikuj nga ana e Universitetit. Gjithashtu, stafi i Universitetit mori pjesë në 18 konferenca shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë vitit akademik 2018-2019, një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe dimensionit të kontributit ndaj shoqërisë, i cili u realizua nëpërmjet organizimit të vizitave dhe të takimeve nga ana e maturantëve në mjediset e Universitetit në kuadër të planifikimit të karrierës, ofrimit të bursave për maturantët më të suksesshëm si dhe përfshirjes aktive të studentëve në aktivitete sociale.

Për sa i përket zbatimit të masave të parashikuara në planin strategjik afatshkurtër, gjatë vitit akademik 2018-2019, u siguria realizimi i masave të mëposhtme:

- përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së studentëve të pranuar në Universitet;
- rritja e numrit të studentëve të Universitetit “EPOKA” të cilët marrin pjesë në programe shkëmbimi në Universitete jashtë vendit, me një numër gjithnjë e në rritje të programeve të shkëmbimit të financuara nga programi Erasmus + i BE-së;
- rritja e numrit të studentëve të huaj që studiojnë në Universitetin “EPOKA” në kuadër të zbatimit të programeve të shkëmbimit;
- përthithja e stafit akademik me përvojë si dhe me grada shkencore dhe tituj akademikë, duke mundësuar mbulimin e pjesës dërrmuese të mësimdhënies nga stafi me kohë të plotë;
- organizimi dhe bashkëorganizimi i një numri të lartë të konferencave dhe aktiviteteve shkencore nga ana e Universitetit;
- përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së publikimeve shkencore të stafit të Universitetit;
- rritja e bashkëpunimit me universitetet dhe institucionet kërkimore-shkencore, brenda dhe jashtë vendit, me një numër gjithnjë e në rritje të përfshirjes së stafit akademik në programin Erasmus+ dhe COST të financuar nga BE;

- rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit nga ana e stafit dhe studentëve;
- përmirësimi i përdorimit të sistemit të automatizimit dhe më konkretisht i sistemit të automatizimit për stafin dhe studentët si dhe i Sistemit të Informacionit mbi Procesin e Mësimdhënies (EIS);
- rritja e kapaciteteve të bibliotekës;
- përmirësimi i shërbimit të ushqimit, akomodimit dhe çlodhjes për studentët;
- shtimi i aktiviteteve social-kulturore për studentët dhe veçanërisht rritja e madhe e aktiviteteve të zhvilluara nga klubet studentore.


Gjatë vitit akademik 2018-2019, Universiteti “EPOKA” vijoi zbatimin e projektit K-FORCE “Dije për një shoqëri rezistente” (Project number:573942-EPP-1-2016-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP), financuar nga programi Erasmus + i BE-së. Udhëheqës i këtij projekti është Universiteti i Novi Sadit në Serbi, i cili bashkërendon konsorciumin e përbërë nga 14 universitete dhe institucione partnere nga BE, Serbia, Shqipëria, Bosnje-Hercegovina dhe Maqedonia (FYROM). Realizimi i aktiviteteve të projektit parashikohet të zgjasë tre vjet, gjatë periudhës tetor 2016 - tetor 2019.

Në rrjedhën e aktiviteteve vjetore, edhe këtë vit, studentët e Universitetit “EPOKA” kanë marrë pjesë në forume, workshope dhe konkurse të ndryshme ndërkombëtare, duke paraqitur projektet dhe punimet e tyre. Gjithashtu, studentët e programeve të studimit Master dhe Doktoraturë janë nxitur të marrin pjesë në konferenca dhe aktivitete të ngjashme për të paraqitur punimet e tyre shkencore dhe kërkimore.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm gjatë vitit akademik 2018-2019 ishte edhe vendi që Universiteti “EPOKA” zuri ndërmjet universiteteve shqiptare në renditjen prestigjioze Webometrics të Universiteteve, e kryer nga Këshilli Kombëtar Spanjoll i Kërkimit. Sipas kësaj renditjeje, Universiteti “EPOKA” zuri vendin e parë në mes të të gjithë universiteteve publike dhe private që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri.

3. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI INSTITUCIONIN

A. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE TITULLARËT E INSTITUCIONIT



Rektor: Prof. Dr. Güngör Turan

Organet vendimmarrëse si dhe njësitë akademike dhe administrative, shoqëruar me titullarët përkatës

1. Bordi i Administrimit

Emër Mbiemër	Detyra
Z. Yakup Arslan	Kryetar
Z. Asim Demiröz	Zv. Kryetar
Z. Fiqiret Muhja	Anëtar
Z. Mustafa Üstüner	Anëtar
Z. Mustafa Aslan	Anëtar
Z. Roland Hoxha	Relator

2. Senati Akademik

Emër Mbiemër	Detyra
Prof. Dr. Güngör Turan	Kryetar
Assoc. Prof. Dr. Lisen Bashkurti	Zv. Kryetar
Prof. Dr. Betim Çiço	Anëtar
Prof. Dr. Teoman Duman	Anëtar
Assoc. Prof. Dr. Salih Özcan	Anëtar
Assoc. Prof. Dr. Sokol Dervishi	Anëtar
Assoc. Prof. Dr. Uğur Ergün	Anëtar
Dr. Xhimi Hysa	Anëtar
Dr. Arban Uka	Anëtar
Dr. Islam Jusufi	Anëtar
Dr. Erion Luga	Anëtar
Dr. Niuton Mulleti	Anëtar dhe Relator
Dr. Reina Shehi	Anëtare
Zj. Qamile Zdrava	Anëtare (<i>Kryetare e Këshillit Studentor</i>)
Z. Mirian Mertiri	Anëtar (<i>Zv. Kryetar i parë i Këshillit Studentor</i>)

3. Rektorati

Emër Mbiemër	Detyra
Prof. Dr. Güngör Turan	Kryetar
Assoc. Prof. Dr. Salih Özcan	Anëtar
Assoc. Prof. Dr. Sokol Dervishi	Anëtar
Assoc. Prof. Dr. Lisen Bashkurti	Anëtar
Z. Roland Hoxha	Anëtar
Z. Sadullah Yılmaz	Anëtar
Zj. Semra Bilgiç Yerlikaya	Anëtare
Dr. Niuton Mulleti	Anëtar dhe Relator

4. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë

Emër Mbiemër	Detyra
Prof. Dr. Teoman Duman	Kryetar
Dr. Timothy Hagen	Anëtar
Dr. Julian Hoxha	Anëtar

Dr. Alba Kruja	Anëtare
Dr. Odeta Manahasa	Anëtare
Dr. Reina Shehi	Anëtare
Z. Altin Bora	Anëtar dhe Relator
Z. Loren Senja	Anëtar
Dr. Idaver Sherifi	Anëtar (<i>I Diplomuar</i>)
Zj. Heliona Miço	Anëtar (<i>Ekspert i jashtëm</i>)
Zj. Ajla Maksuti	Anëtare (<i>Zv. Kryetare e Këshillit Studentor për çështjet e sigurimit të cilësisë</i>)

Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – Zj. Flogerta Hasanaj (Përgjegjëse)

5. Këshilli i Etikës

Emër Mbiemër	Detyra
Zj. Geland Shkurtaç	Kryetare
Prof. Dr. Teoman Duman	Anëtar
Dr. Julinda Keçi	Anëtare
Zj. Semra Bilgiç Yerlikaya	Anëtare
Zj. Eva Jazaj	Anëtare (<i>Zv. Kryetare e Këshillit Studentor për çështjet e etikës</i>)

6. Bordi i Provimeve

Emër Mbiemër	Detyra
Dr. Anna Yunitsyna	Kryetare
Dr. Naqeeb Ur Rehman	Anëtar
Zj. Jubjana Vila	Anëtare

7. Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët

Emër Mbiemër	Detyra
Z. Sadullah Yılmaz	Kryetar
Zj. Semra Bilgiç Yerlikaya	Zv. Kryetare
Z. Enea Mançellari	Anëtar
Z. Besjon Zenelaj	Anëtar
Zj. Jubjana Vila	Anëtare
Zj. Emanuela Senja	Anëtare
Z. Ermion Jaho	Anëtar
Zj. Ajla Maksuti	Anëtare (<i>e zgjedhur nga Këshilli Studentor</i>)

Z. Gerild Pjetri	Anëtar (i zgjedhur nga Këshilli Studentor)
------------------	--

8. Këshilli Studentor

Emër Mbiemër	Detyra
Qamile Zdrava	Kryetare
Mirian Mertiri	Zv. Kryetar i parë
Ajla Maksuti	Zv. Kryetare për çështjet e sigurimit të cilësisë
Eva Jazaj	Zv. Kryetare për çështjet e etikës
Judoris Merkaj	Sekretar i Përgjithshëm
Juli Dema	Anëtare
Kevin Vishe	Anëtar
Olta Muça	Anëtare
Amela Rahimi	Anëtare
Klaus Çepani	Anëtar
Xhulja Xhaho	Anëtare
Sando Zejno	Anëtar
Greis Rama	Anëtare
Joana Doko	Anëtare
Tea Çapuni	Anëtare
Oriana Bani	Anëtare
Bruno Recka	Anëtar
Olgert Magilaj	Anëtar
Egist Diko	Anëtar
Gerild Pjetri	Anëtar
Erida Nurçe	Anëtare
Arlindo Toro	Anëtar
Marsida Muhaj	Anëtare
Dorel Habili	Anëtar
Eva Jazaj	Anëtare

9. Kabineti i Rektorit

Zj. Alba Gërdeci

10. Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Zj. Alba Gërdeci

11. Zyra e Hulumtimit dhe Projekteve

Z. Esmir Demaj

12. Administrator – Z. Roland Hoxha

- Zyra e Financës – Z. Murat Büyükbulut
- Zyra e Marrëdhënieve me Median dhe Publikun – Z. Oltjon Rukaj
- Zyra e Çështjeve Administrative dhe Teknike – Z. Yunis Kaş
- Zyra e Prokurimeve dhe Logjistikës – Z. Yunis Kaş
- Zyra e Burimeve Njerëzore – Z. Genci Murja
- Zyra Koordinuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit – Z. Ali Osman Topal
- Zyra e Sekretarisë Mësimore – Z. Denis Stena
- Zyra e Pranimit të Studentëve – Z. Loren Senja
- Biblioteka – Z. Metin Gerra

13. Dekanati i Studentëve

Dekan i Studentëve – Z. Sadullah Yılmaz

Zv. Dekane e Studentëve – Zj. Semra Bilgiç Yerlikaya

14. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë

Dekan: Assoc. Prof. Dr. Sokol Dervishi

Administratore: Zj. Morena Mulhaxhia

- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
Përgjegjës i Departamentit: Dr. Arban Uka;
- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
Përgjegjëse e Departamentit: Assoc. Prof. Dr. Miriam Ndini;
- Departamenti i Arkitekturës;
Përgjegjës i Departamentit: Dr. Edmond Manahasa

15. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative

Dekan: Assoc. Prof. Dr. Salih Özcan

Administrator: Z. Tekim Peza

- Departamenti i Ekonomiksit;
Përgjegjëse e Departamentit: Assoc. Prof. Dr. Eglantina Hysa
- Departamenti i Financë-Bankës;
Përgjegjës i Departamentit: Assoc. Prof. Dr. Uğur Ergün
- Departamenti i Administrim Biznesit;
Përgjegjës i Departamentit: Dr. Xhimi Hysa

16. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale

Dekan: Assoc. Prof. Dr. Lisen Bashkurti

Administrator: Z. Ervin Sulika

- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
Përgjegjës i Departamentit: Dr. Islam Jusufi
- Departamenti i Drejtësisë
Përgjegjësi i komanduar i Departamentit: Dr. Niuton Mulleti
- Qendra për Studime Europiane
Përgjegjëse e Qendrës: Dr. Reina Shehi

**B. PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA NGA ANA E UNIVERSITETIT SI DHE
PROGRAMET E STUDIMIT NË PROCES LICENCIMI**

i. Studimet e ciklit të parë – në përfundim të të cilave lëshohet diplomë “Bachelor”

1. Programi i studimeve të ciklit të parë në Inxhinieri Ndërtimi - *Diplomë Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi*;
2. Programi i studimeve të ciklit të parë në Inxhinieri Kompjuterike - *Diplomë Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike*;
3. Programi i studimeve të ciklit të parë në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital - *Diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital*;
4. Programi i studimeve të ciklit të parë në Financë-Bankë - *Diplomë Bachelor në Financë- Bankë*;
5. Programi i studimeve të ciklit të parë në Financë-Bankë (në gjuhën shqipe) - *Diplomë Bachelor në Financë- Bankë (Shqip)*;
6. Programi i studimeve të ciklit të parë në Administrim Biznesi - *Diplomë Bachelor në Administrim Biznesi*;
7. Programi i studimeve të ciklit të parë në Ekonomiks - *Diplomë Bachelor në Ekonomiks*;
8. Programi i studimeve të ciklit të parë në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare – *Diplomë Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare*;
9. Programi i studimeve të ciklit të parë në Informatikë-Ekonomike - *Diplomë Bachelor në Informatikë-Ekonomike*;
10. Programi i studimeve të ciklit të parë në Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik - *Diplomë Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik*.

ii. Studimet e ciklit të dytë – në përfundim të të cilave lëshohet diplomë “Master i Shkencave”

1. Programi i studimeve Master i Shkencave në Arkitekturë;
2. Programi i studimeve Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me katër profile:
 - a) Profili: Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit;
 - b) Profili: Menaxhim i Ndërtimeve;
 - c) Profili: Inxhinieri e Resurseve Ujore;
 - d) Profili: Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit.
3. Programi i studimeve Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike;
4. Programi i studimeve Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni;
5. Programi i studimeve Master i Shkencave në Financë-Bankë;
6. Programi i studimeve Master i Shkencave në Administrim Biznesi;
7. Programi i studimeve Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare;

8. Programi i studimeve Master i Shkencave në Ekonomiks.
- iii. **Studimet e integruara të ciklit të dytë – në përfundim të të cilave lëshohet diplomë "Master i Shkencave"**
1. Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë në Arkitekturë - *Master i Shkencave në Arkitekturë*;
 2. Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë në Drejtësi - *Master i Shkencave në Drejtësi*.
- iv. **Studimet e ciklit të dytë – në përfundim të të cilave lëshohet diplomë "Master Profesional"**
1. Programi i studimeve Master Profesional në Inxhinieri Ndërtimi;
 2. Programi i studimeve Master Profesional në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit;
 3. Programi i studimeve Master Profesional në Inxhinieri Kompjuterike;
 4. Programi i studimeve Master Profesional në Financë-Bankë;
 5. Programi i studimeve Master Profesional në Administrim Biznesi;
 6. Programi i studimeve Master Profesional në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare;
- v. **Studime të ciklit të tretë të Doktoratës – në përfundim të të cilave jepet grada shkencore "Doktor"**
1. Programi i studimeve të ciklit të tretë *Doktoratë në Arkitekturë*;
 2. Programi i studimeve të ciklit të tretë *Doktoratë në Inxhinieri Ndërtimi*;
 3. Programi i studimeve të ciklit të tretë *Doktoratë në Inxhinieri Kompjuterike*;
 4. Programi i studimeve të ciklit të tretë *Doktoratë në Ekonomiks* me dy profile:
 - a) Profili: Ekonomiks;
 - b) Profili: Financë-Bankë;
 5. Programi i studimeve të ciklit të tretë *Doktoratë në Administrim Biznesi*;
 6. Programi i studimeve të ciklit të tretë *Doktoratë në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare*.

Programet e mëposhtme të studimit aktualisht nuk janë aktive:

1. Programi i studimeve Master Profesional në Arkitekturë;
 2. Programi i studimeve Master Profesional në Studime Evropiane;
 3. Programi i studimeve Master Profesional në Menaxhim Biznesi: Profili: Menaxhim Arsimi.
- Në të njëjtën kohë, programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Softueri aktualisht është në proces licensimi.

C. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME NUMERIKE MBI INSTITUCIONIN

1. NIVELET DHE PROGRAMET E STUDIMIT QË OFRON INSTITUCIONI;

a) Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ofron:

Programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Bachelor:

- i. Inxhinieri Ndërtimi;
- ii. Inxhinieri Kompjuterike;
- iii. Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital.

Programet e studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Master i Shkencave:

- i. Master i Shkencave në Arkitekturë;
- ii. Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike;
- iii. Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi (Profillet: Menaxhim i Ndërtimeve; Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit; Inxhinieri e Resurseve Ujore; Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit);
- iv. Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni.

Program i integruar i studimit të ciklit të dytë në Arkitekturë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Master i Shkencave në Arkitekturë.

Programet e studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet diplomë Master Profesional:

- i. Master Profesional në Inxhinieri Kompjuterike;
- ii. Master Profesional në Inxhinieri Ndërtimi;
- iii. Master Profesional në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit.

Programet e studimit të ciklit të tretë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave jepet grada shkencore "Doktor":

- i. Doktoratë në Arkitekturë;
- ii. Doktoratë në Inxhinieri Ndërtimi;
- iii. Doktoratë në Inxhinieri Kompjuterike.

b) Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ofron:

Programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimeve me kohë të plotë, në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Bachelor:

- i. Ekonomiks;
- ii. Financë-Bankë;
- iii. Financë-Bankë në gjuhën shqipe;
- iv. Administrim Biznesi;
- v. Informatikë Ekonomike;
- vi. Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.

Programet e studimit të ciklit të dytë në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Master i Shkencave :

- i. Master i Shkencave në Financë-Bankë;
- ii. Master i Shkencave në Administrim Biznesi;
- iii. Master i Shkencave në Ekonomiks;

Programet e studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet diplomë Master Profesional:

- i. Master Profesional në Financë-Bankë;
- ii. Master Profesional në Administrim Biznesi.

Programet e studimit të ciklit të tretë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave jepet grada shkencore “Doktor”:

- i. Doktoratë në Ekonomiks me dy profile:
 - a. Profili: Ekonomiks;
 - b. Profili: Financë-Bankë.
- ii. Doktoratë në Administrim Biznesi;

c) Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale ofron:

Programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimeve me kohë të plotë, në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Bachelor:

- i. Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare;

Programet e studimit të ciklit të dytë në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Master i Shkencave :

- i. Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Programet e studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet diplomë Master Profesional:

- i. Master Profesional në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Program i integruar i studimit të ciklit të dytë në Drejtësi, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Master i Shkencave në Drejtësi.

Programet e studimit të ciklit të tretë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave jepet grada shkencore “Doktor”:

- i. Doktoratë në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

2. NUMRI I PËRGJITHSHËM I STUDENTËVE TË REGJISTRUAR SIPAS NIVELEVE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT 2018-2019;

Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	CIKLI I PARË	CIKLI I DYTË			CIKLI I TRETË	TOTALI
	BA	DIND	MP	MSc	PhD	
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISË	146	51	30	35	4	266
INXHINIERI NDËRTIMI	23	-	21	13	1	58

INXHINIERI KOMPJUTERIKE	90	-	9	16	2	117
ARKITEKTURË	-	51	-	1	1	53
INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKIMI DIXHITAL	33	-	-	5	-	38
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE	293	-	21	66	2	382
FINANCË-BANKË	80	-	11	33	0	124
FINANCË-BANKË (Shqip)	22	-	-	-	-	22
ADMINISTRIM BIZNESI	30	-	10	28	1	69
EKONOMIKS	35	-	-	5	1	41
INFORMATIKË EKONOMIKE	89	-	-	-	-	89
MARKETING NDËRKOMBËTAR DHE MENAXHIM LOGJISTIKE	37	-	-	-	-	37
FAKULTETI I DREJTESISË DHE I SHKENCAVE SOCIALE	16	20	3	5	3	47
SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	16	-	3	5	3	27
DREJTESI	-	20	-	-	-	20
TOTALI	455	71	54	106	9	695

3. NUMRI I TË DIPLOMUARVE SIPAS NIVELEVE DHE PROGRAMIT TË STUDIMIT 2018-2019;

Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	CIKLI I PARË	CIKLI I DYTË			CIKLI I TRETË	TOTALI
	BA	DIND	MP	MSc	PhD	
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISË	75	15	28	21	1	140
INXHINIERI NDËRTIMI	9	-	21	10	0	40
INXHINIERI KOMPJUTERIKE	35	-	7	4	1	47
ARKITEKTURË	-	15	-	5	0	20
INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKIMI DIXHITAL	31	-	-	2	-	33
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE	215	-	14	28	0	257
FINANCË-BANKË	64	-	5	14	0	83
FINANCË-BANKË (SHQIP)	32	-	-	-	-	32
ADMINISTRIM BIZNESI	27	-	9	12	0	48
EKONOMIKS	21	-	-	2	0	23
INFORMATIKË EKONOMIKE	58	-	-	-	-	58
MARKETING NDËRKOMBËTAR DHE MENAXHIM LOGJISTIKE	13	-	-	-	-	13

FAKULTETI I DREJTESISË DHE I SHKENCAVE SOCIALE	18	0	1	3	0	22
SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	18	-	1	3	0	22
DREJTESI	-	0	-	-	-	-
TOTALI	308	15	43	52	1	419

4. NUMRI I STUDENTËVE TË TRANSFERUAR 2018-2019 (SHOQËRUAR ME INFORMACION MBI INSTITUCIONIN E PARË, PROGRAMIN E STUDIMIT DHE SEMESTRIN KU TRANSFEROHET);

NR.	PROGRAMI I STUDIMIT	SEMESTRI KU TRANSFEROHET	INSTITUCIONI I PARE
1	BA INXHINIERI KOMPJUTERIKE	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
2	BA INXHINIERI KOMPJUTERIKE	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
3	BA INXHINIERI KOMPJUTERIKE	SEMESTRI I PESTË	TRANSFERTË NGA JASHTË VENDIT
4	BA INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKIM DIXHITAL	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
5	BA INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKIM DIXHITAL	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
6	BA FINANCË-BANKË	SEMESTRI I TRETË	KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT
7	BA FINANCË-BANKË	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI I TIRANËS
8	BA FINANCË-BANKË (SHQIP)	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
9	BA FINANCË-BANKË (SHQIP)	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
10	BA FINANCË-BANKË (SHQIP)	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
11	BA ADMINISTRIM BIZNESI	SEMESTRI I PESTË	UNIVERSITETI METROPOLITAN
12	BA ADMINISTRIM BIZNESI	SEMESTRI I PESTË	UNIVERSITETI EPOKA
13	BA ADMINISTRIM BIZNESI	SEMESTRI I PESTË	UNIVERSITETI EPOKA

14	BA ADMINISTRIM BIZNESI	SEMESTRI I TRETË	TRANSFERTË NGA JASHTË VENDIT
15	BA ADMINISTRIM BIZNESI	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
16	BA INFORMATIKË EKONOMIKE	SEMESTRI I TRETË	TRANSFERTË NGA JASHTË VENDIT
17	BA INFORMATIKË EKONOMIKE	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
18	BA EKONOMIKS	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
19	BA EKONOMIKS	SEMESTRI I TRETË	TRANSFERTË NGA JASHTË VENDIT
20	BA MARKETING NDËRKOMBËTAR DHE MENAXHIM LOGJISTIK	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
21	BA SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS
22	BA SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	SEMESTRI I TRETË	TRANSFERTË NGA JASHTË VENDIT
23	MSc ARKITEKTURË	SEMESTRI I PARË	TRANSFERTË NGA JASHTË VENDIT
24	MSc INXHINIERI NDËRTIMI	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
25	MSc INXHINIERI NDËRTIMI	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
26	MSc INXHINIERI NDËRTIMI	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
27	MSc FINANCË-BANKË	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
28	MSc FINANCË-BANKË	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
29	MSc FINANCË-BANKË	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
30	MSc FINANCË-BANKË	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA
31	MSc SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	SEMESTRI I TRETË	UNIVERSITETI EPOKA

5. Pagesat totale (tarifat e studimit, regjistrimit etj.) për secilin program studimi në bazë të kohëzgjatjes së studimit

Tarifat e studimit për vitin akademik 2018-2019 kanë qenë si më poshtë vijon:

Fakulteti	Tarifa e programeve Bachelor	Tarifa e programeve Master i Shkencave/Master Profesional
Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë (Përveç Arkitekturës)	3.500 Euro për vit akademik	2.450 Euro për vit akademik
Arkitekturë	3.600 Euro për vit akademik	3.600 Euro për vit akademik
Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative (Përveç Financë-Bankë Shqip)	2.500 Euro për vit akademik	1.950 Euro për vit akademik
Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, Program i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në Drejtësi	2.800 Euro për vit akademik	-
Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	2.500 Euro për vit akademik	1.950 Euro për vit akademik
Financë-Bankë (Shqip)	1.750 Euro për vit akademik	-

6. NUMRI I PËRGJITHSHËM I PERSONELIT AKADEMIK (TË LISTUAR SË BASHKU ME TË DHËNAT MBI NUMRIN E PROF., DR., ETJ. DHE RAPORTET STUDENTË/PROFESORË)

1. Lista e stafit akademik për semestrin e vjeshtës, viti akademik 2018-2019:

Departamenti i Arkitekturës

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punësimi
Sokol Dervishi	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Edmond Manahasa	Dr.	Me kohë të plotë
Anna Yunitsyna	Dr.	Me kohë të plotë
Odetta Manahasa	Dr.	Me kohë të plotë
Fabio Naselli	Dr.	Me kohë të plotë
Egin Zeka	M.Sc	Me kohë të plotë

Artan Hysa	M.Sc	Me kohë të plotë
Desantila Hysa	M.Sc	Me kohë të plotë
Frida Pashako	Dr.	Me kohë të pjesshme
Dorian Tytymçe	M.Sc	Me kohë të pjesshme
Piro Vaso	M.Sc	Me kohë të pjesshme
Jurtin Hajro	M.Sc	Me kohë të pjesshme
Teuta Kodra	M.Sc	Me kohë të pjesshme
Kreshnik Merxhani	M.Sc	Me kohë të pjesshme

Departmenti i Inxhinierisë së Ndërtimit

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punesimi
Mirjam Ndini	Assoc.Prof.Dr.	Me kohë të plotë
Hüseyin Bilgin	Assoc.Prof.Dr	Me kohë të plotë
Erion Luga	Dr.	Me kohë të plotë
Enea Mustafaraj	Dr.	Me kohë të plotë
Julinda Keçi	Dr.	Me kohë të plotë
Endrit Hoxha	Dr.	Me kohë të plotë
Armando Demaj	M.Sc.	Me kohë të plotë
Erdi Myftaraga	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Vasil Leka	M.Sc.	Me kohë të pjesshme

Departmenti i Inxhinierisë Kompjuterike

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punesimi
Arban Uka	Dr.	Me kohë të plotë
Betim Çiço	Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Dimitrios Karras	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Ito Wasito	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Khalid Masood	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Ali Osman Topal	Dr.	Me kohë të plotë
Julian Hoxha	Dr.	Me kohë të plotë

Mükremin Özkul	M.Sc.	Me kohë të plotë
Igli Hakrama	M. Sc.	Me kohë të plotë
Florenc Skuka	M.Sc.	Me kohë të plotë
Hakan Yozgatli	M.Sc	Me kohë të plotë
Enea Maçellari	M. Sc.	Me kohë të plotë
Mirela Alhasani	M. Sc.	Me kohë të plotë
Fatos Ylli	Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Margarita Ifti	Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Erind Bedalli	Dr.	Me kohë të pjesshme
Blerina Zanaj	Dr.	Me kohë të pjesshme
Besiana Çobani	Dr.	Me kohë të pjesshme
Albana Halili	Dr.	Me kohë të pjesshme
Klaudio Pegini	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Kristel Bozhiqi	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Ndriçim Topalli	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Ernaso Kërbizi	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Erion Mali	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Jezerca Hodaj	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Saimir Kokonozi	M.Sc.	Me kohë të pjesshme

Departamenti i Ekonomiksit

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punesimi
Eglantina Hysa	Assoc.Prof.Dr.	Me kohë të plotë
Güngör Turan	Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Timothy Hagen	Dr.	Me kohë të plotë
Naqeeb Ur Rehman	Dr.	Me kohë të plotë
Fatih Mehmet Karakuş	M.Sc.	Me kohë të plotë
Erjon Gjoçi	M.Sc.	Me kohë të plotë
Semra Bilgiç Yerlikaya	M.Sc.	Me kohë të plotë

Departmenti i Financë-Bankës

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punesimi
Ugur Ergün	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Nertil Mera	Dr.	Me kohë të plotë
Chrysanthi Balomenou	Dr.	Me kohë të plotë
Patrice Kandolo Kabeya	Dr.	Me kohë të plotë
Moustapha Daouda Dala	Dr.	Me kohë të plotë
Gojart Kamberi	Dr.	Me kohë të plotë
Erinda Imeraj	M.Sc	Me kohë të plotë
Jonada Mamo	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Bledar Hoda	Dr.	Me kohë të pjesshme
Kristal Hykaj	Dr.	Me kohë të pjesshme
Juliana Imeraj	Dr.	Me kohë të pjesshme
Lindita Mukli	Dr.	Me kohë të pjesshme
Arjeta Hallunovi	Dr.	Me kohë të pjesshme
Avenir Lleshanaku	Dr.	Me kohë të pjesshme
Iliriana Kraja	M.Sc.	Me kohë të pjesshme

Departmenti i Administrim Biznesit

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punesimi
Xhimi Hysa	Dr.	Me kohë të plotë
Teoman Duman	Prof.Dr.	Me kohë të plotë
Mustafa Ūç	Assoc.Prof.Dr.	Me kohë të plotë
Vusal Gambarov	Dr.	Me kohë të plotë
Alba Kruja	Dr.	Me kohë të plotë
Besjon Zenelaj	M.Sc.	Me kohë të plotë
Esmir Demaj	M.Sc.	Me kohë të plotë
Lindita Gjika (Cepani)	Dr.	Me kohë të pjesshme
Sonila Zerelli	Dr.	Me kohë të pjesshme
Florian Tahiri	M.Sc.	Me kohë të pjesshme

Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punesimi
Islam Jusufi	Dr.	Me kohë të plotë
Salih Özcan	Assoc.Prof.Dr	Me kohë të plotë
Lisen Bashkurti	Assoc.Prof.Dr.	Me kohë të plotë
Avdi Smajljaj	Dr.	Me kohë të plotë
Ari Weinstein	Dr.	Me kohë të plotë
Altin Bora	M.Sc.	Me kohë të plotë
Jubjana Vila	M.Sc.	Me kohë të plotë
Gjergji Sinani	Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Eglantina Gishti	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Ardjana Braja	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Nensi Gjetani	M.Sc.	Me kohë të pjesshme

Departamenti i Drejtësisë

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punesimi
Niuton Mulleti	Dr.	Me kohë të plotë
Enver Hasani	Prof.Dr.	Me kohë të plotë
Gelanda Shkurtaj	Dr.	Me kohë të plotë
Besfort Rrecaj	Dr.	Me kohë të plotë
Alba Gërdeci	M.Sc.	Me kohë të plotë
Eglantina Farruku	M.Sc.	Me kohë të plotë
Sadullah Yilmaz	M.Sc.	Me kohë të plotë
Hasan Bello	Dr.	Me kohë të pjesshme
Erjon Hitaj	Dr.	Me kohë të pjesshme
Enkelejd Alibeaj	Dr.	Me kohë të pjesshme

Qendra për Studime Europiane

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punesimi
Reina Shehi	Dr.	Me kohë të plotë
Idaver Sherifi	Dr.	Me kohë të plotë
Endri Stoja	Dr.	Me kohë të plotë
Genci Murja	M.Sc.	Me kohë të plotë
Endri Pajollari	M.Sc.	Me kohë të plotë
Ina Dervishi	M.Sc.	Me kohë të plotë
Artemis Hasa	M.Sc.	Me kohë të plotë

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë

	Me kohë të plotë					Me kohë të pjesshme					Gjithsej staf akademik				
Departamenti	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej
Arkitekturë	0	1	4	3	8	0	0	1	5	6	0	1	5	8	14
Inxhinieri Ndërtimi	0	2	4	1	7	0	0	0	2	2	0	2	4	3	9
Inxhinieri Kompjuterike	1	3	3	6	13	2	0	4	7	13	3	3	7	13	26
Gjithsej	1	6	11	10	28	2	0	5	14	21	3	6	16	24	49

Fakulteti i Ekonomiksit dhe Shkencave Administrative

	Me kohë të plotë					Me kohë të pjesshme					Gjithsej staf akademik				
Departamenti	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej
Ekonomiks	1	1	2	3	7	0	0	0	0	0	1	1	2	3	7
Financë-Bankë	0	1	5	1	7	0	1	6	1	8	0	2	11	2	15
Administrim-Biznesi	1	1	3	2	7	0	0	2	1	3	1	1	5	3	10
Gjithsej	2	3	10	6	21	0	1	8	2	11	2	4	18	8	32

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale															
Departamenti	Me kohë të plotë					Me kohë të pjesshme					Gjithsej staf akademik				
	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej
Shk. Pol dhe Marrëdhëniet. Ndërkombëtare	0	2	3	2	7	1	2	0	1	4	1	4	3	3	11
Drejtësisë	1	0	3	3	7	0	0	3	0	3	1	0	6	3	10
Q e Studimeve Evropiane	0	0	3	4	7	0	0	0	0	0	0	0	3	4	7
Gjithsej	1	2	9	9	21	1	2	3	1	7	2	4	12	10	28

Universiteti "EPOKA"															
Me kohë të plotë					Me kohë të pjesshme					Gjithsej staf akademik					
Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	
4	11	30	25	70	3	3	16	17	39	7	14	46	42	109	

Viti Akademik 2018-2019, Semestri i Vjeshtës			
	Nr. i pedagogëve	Nr. i studentëve	Raporti Student/Pedagog
Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë	49	844	17.2
Fakulteti i Ekonomiksit dhe Shkencave Administrative	32	1106	34.6
Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale	28	133	4.8
Universiteti "EPOKA"	109	2083	19.1

2. Lista e stafit akademik për semestrin e pranverës, viti akademik 2018-2019:

Departamenti i Arkitekturës

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punësimi
Edmond Manahasa	Dr.	Me kohë të plotë
Sokol Dervishi	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Anna Yunitsyna	Dr.	Me kohë të plotë
Odeta Manahasa	Dr.	Me kohë të plotë
Fabio Naselli	Dr.	Me kohë të plotë

Artan Hysa	Dr.	Me kohë të plotë
Egin Zeka	M.Sc.	Me kohë të plotë
Desantila Hysa	M.Sc.	Me kohë të plotë
Frida Pashako	Dr.	Me kohë të pjesshme
Dorian Tytymçe	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Jurtin Hajro	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Piro Vaso	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Klevis Zaimaj	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Gentian Shkurti	M.Sc.	Me kohë të pjesshme

Departmenti i Inxhinierisë së Ndërtimit

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punësimi
Mirjam Ndini	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Hüseyin Bilgin	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Erion Luga	Dr.	Me kohë të plotë
Enea Mustafaraj	Dr.	Me kohë të plotë
Julinda Keçi	Dr.	Me kohë të plotë
Endrit Hoxha	Dr.	Me kohë të plotë
Armando Demaj	M.Sc.	Me kohë të plotë
Ylber Muçeku	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme

Departmenti i Inxhinierisë Kompjuterike

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punësimi
Arban Uka	Dr.	Me kohë të plotë
Betim Çiço	Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Dimitrios Karras	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Ali Osman Topal	Dr.	Me kohë të plotë
Julian Hoxha	Dr.	Me kohë të plotë
Igli Hakrama	Dr.	Me kohë të plotë
Mükremin Özkul	M.Sc.	Me kohë të plotë

Florenc Skuka	M.Sc.	Me kohë të plotë
Enea Maçellari	M.Sc.	Me kohë të plotë
Mirela Alhasani	M.Sc.	Me kohë të plotë
Fatos Ylli	Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Polikron Dhoqina	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Erind Bedalli	Dr.	Me kohë të pjesshme
Blerina Zanaj	Dr.	Me kohë të pjesshme
Klaudio Peqini	Dr.	Me kohë të pjesshme
Albana Halili	Dr.	Me kohë të pjesshme
Kristel Bozhiqi	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Ndriçim Topalli	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Ernas Kërbizi	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Erion Mali	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Jezerca Hodaj	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Sabri Topsakal	M.Sc.	Me kohë të pjesshme

Departmenti i Ekonomiksit

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punësimi
Eglantina Hysa	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Güngör Turan	Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Timothy Hagen	Dr.	Me kohë të plotë
Naqeeb Ur Rehman	Dr.	Me kohë të plotë
Fatih Mehmet Karakuş	M.Sc.	Me kohë të plotë
Erjon Gjoçi	M.Sc.	Me kohë të plotë
Semra Bilgiç Yerlikaya	M.Sc.	Me kohë të plotë

Departmenti i Financë-Bankës

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punësimi
Ugur Ergün	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Nertil Mera	Dr.	Me kohë të plotë

Chrysanthi Balomenou	Dr.	Me kohë të plotë
Moustapha Daouda Dala	Dr.	Me kohë të plotë
Erinda Imeraj	Dr.	Me kohë të plotë
Hakan Yozgath	M.Sc.	Me kohë të plotë
Drini Salko	Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Fatbardha Kadiu	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Orfea Dhuci	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Jonada Mamo	Dr.	Me kohë të pjesshme
Kristal Hykaj	Dr.	Me kohë të pjesshme
Lindita Mukli	Dr.	Me kohë të pjesshme
Arjeta Hallunovi	Dr.	Me kohë të pjesshme
Albana Demi	Dr.	Me kohë të pjesshme
Arben Zibri	Dr.	Me kohë të pjesshme
Avenir Lleshanaku	M.Sc.	Me kohë të pjesshme
Iliriana Kraja	M.Sc.	Me kohë të pjesshme

Departmenti i Administrim Biznesit

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punësimi
Xhimi Hysa	Dr.	Me kohë të plotë
Teoman Duman	Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Mustafa Uç	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Vusal Gambarov	Dr.	Me kohë të plotë
Alba Kruja	Dr.	Me kohë të plotë
Besjon Zenelaj	M.Sc.	Me kohë të plotë
Esmir Demaj	M.Sc.	Me kohë të plotë
Lindita Gjika (Cepani)	Dr.	Me kohë të pjesshme
Sonila Zerelli	Dr.	Me kohë të pjesshme
Florian Tahiri	M.Sc.	Me kohë të pjesshme

Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punësimi
Islam Jusufi	Dr.	Me kohë të plotë
Salih Özcan	Assoc.Prof.Dr	Me kohë të plotë
Lisen Bashkurti	Assoc.Prof.Dr.	Me kohë të plotë
Avdi Smajljaj	Dr.	Me kohë të plotë
Ari Weinstein	Dr.	Me kohë të plotë
Altin Bora	M.Sc.	Me kohë të plotë
Jubjana Vila	M.Sc.	Me kohë të plotë
Ada Cara	M.A.	Me kohë të pjesshme
Eglantina Gishti	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Ardjana Braja	Assoc. Prof. Dr.	Me kohë të pjesshme
Nensi Gjetani	M.Sc.	Me kohë të pjesshme

Departamenti i Drejtësisë

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punesimi
Niuton Mulleti	Dr.	Me kohë të plotë
Enver Hasani	Prof. Dr.	Me kohë të plotë
Gelanda Shkurtaç	Dr.	Me kohë të plotë
Besfort Rrecaj	Dr.	Me kohë të plotë
Alba Gërdeci	M.Sc.	Me kohë të plotë
Eglantina Farruku	M.Sc.	Me kohë të plotë
Sadullah Yilmaz	Dr.	Me kohë të plotë
Ilirjana Kaceli	Dr.	Me kohë të pjesshme
Gotse Naumovsky	Dr.	Me kohë të pjesshme

Qendra për Studime Europiane

Emri Mbiemri	Titulli akademik	Punesimi
Reina Shehi	Dr.	Me kohë të plotë
Idaver Sherifi	Dr.	Me kohë të plotë

Endri Stoja	Dr.	Me kohë të plotë
Genci Murja	M.Sc.	Me kohë të plotë
Endri Pajollari	M.Sc.	Me kohë të plotë
Ina Dervishi	M.Sc.	Me kohë të plotë
Artemis Hasa	M.Sc.	Me kohë të plotë

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë															
	Me kohë të plotë					Me kohë të pjesshme					Gjithsej staf akademik				
Departamenti	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej
Arkitekturë	0	1	5	2	8	0	0	1	5	6	0	1	6	7	14
Inxhinieri Ndërtimi	0	2	4	1	7	0	1	0	0	1	0	3	4	1	8
Inxhinieri Kompjuterike	1	1	4	4	10	1	1	4	6	12	2	2	8	10	22
Gjithsej	1	4	13	7	25	1	2	5	11	19	2	6	18	18	44

Fakulteti i Ekonomiksit dhe Shkencave Administrative															
	Me kohë të plotë					Me kohë të pjesshme					Gjithsej staf akademik				
Departamenti	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej
Ekonomiks	1	1	2	3	7	0	0	0	0	0	1	1	2	3	7
Financë-Bankë	0	1	4	1	6	1	2	6	2	11	1	3	10	3	17
Administrim-Biznesi	1	1	3	2	7	0	0	2	1	3	1	1	5	3	10
Gjithsej	2	3	9	6	20	1	2	8	3	14	3	5	17	9	34

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale															
	Me kohë të plotë					Me kohë të pjesshme					Gjithsej staf akademik				
Departamenti	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej
Shk. Pol dhe Marrëdhëniet. Ndërkombëtare	0	2	3	2	7	0	2	0	2	4	0	4	3	4	11

Drejtësisë	1	0	4	2	7	0	0	2	0	2	1	0	6	2	9
Q e Studimeve Evropiane	0	0	3	4	7	0	0	0	0	0	0	0	3	4	7
Gjithsej	1	2	10	8	21	0	2	2	2	6	1	4	12	10	27
Universiteti “EPOKA”															
Staf me kohë të plotë					Staf me kohë të pjesshme					Gjithsej staf akademik					
Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr	Master	Gjithsej	
4	9	32	21	66	2	6	15	16	39	6	15	47	37	105	

Viti Akademik 2018-2019, Semestri i Pranverës			
	Nr. i pedagogëve	Nr. i studentëve	Raporti Student/Pedagog
Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë	44	821	18.7
Fakulteti i Ekonomikut dhe Shkencave Administrative	34	1081	31.8
Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale	27	133	4.9
Universiteti “EPOKA”	105	2035	19.4

D. DOKUMENTI MBI PERFORMANCËN E SHKOLLËS, I CILI PËRMBAN:

1. Përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që përfundojnë arsimin e lartë¹;

Cikli I Parë															
Universiteti “EpoKa”	Viti I Parë			Viti i Dytë			Viti Tretë ²			Viti i Katërt			Viti i Peste		
Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	Regjistruar	Kaluan ne vitin pasardhës	Përqindja e studentëve kalues	Regjistruar	Kaluan ne vitin pasardhës	Përqindja e studentëve kalues	Regjistruar	U diplomuan	Përqindja e studentëve që diplomohen	Regjistruar	U diplomuan	Përqindja e studentëve që diplomohen	Regjistruar	U diplomuan	Përqindja e studentëve që diplomohen
Fakulteti i Arkitektu rës dhe Inxhinieris ë	197	181	92 %	165	158	96%	231	64	28%	32	0	-	80	12	15%
Inxhinieri ndërtimi	28	27	97 %	29	28	97%	27	10	37%	-	-	-	-	-	-
Inxhinieri kompjuteri ke	87	81	94%	62	59	96%	95	27	29%	-	-	-	-	-	-
Dind-arkitektur ë ³	51	45	89%	43	42	98%	40	0	-	32	0	-	80	12	15%
Inxhinieri elektronik e dhe komunikimi dixhital	31	28	91%	31	29	94%	69	27	40%	-	-	-	-	-	-
Fakulteti i Shkencave ekonomike dhe Administra tive	277	264	96 %	218	209	96%	387	194	51%	-	-	-	-	-	-
Financë-bankë	78	76	98%	45	44	98%	103	60	59%	-	-	-	-	-	-

¹Në Universitetin "EPOKA", studentët vlerësohen sipas një sistemi të bazuar në notën maksimale të barazvlefshme me 4.00. Në programet e të tre cikleve, në mënyrë që studentët të diplomohen, duhet të kenë arritur në përfundim të studimeve një mesatare të përgjithshme prej më së paku 2.00 nga 4.00. Në të njëjtën kohë, studentët mund të marrin çdo semestër një ngarkesë maksimale prej 45 ECTS. Sistemi i vlerësimit të rezultateve të studentëve tek Universiteti "EPOKA" nuk është i bazuar tek kalimi i vitit, por tek kalimi i lëndëve në bazë semestrale. Për këtë arsye, treguesi më i saktë i kalueshmërisë tek Universiteti "EPOKA" është ai i vitit të fundit të kohëzgjatjes normale të studimeve në programin përkatës të studimit..

² Në vitin e tretë është i paraqitur sistemi 3-vjeçar si edhe sistemi 4-vjeçar, ku përfshihen edhe studentët e prapambetur.

³ DIND në Arkitekturë pas vitit të tretë është lënë e paplotësuar, për arsye se është program i integruar 5-vjeçar.

FINANCË-BANKË (SHQIP)	19	19	100%	20	20	100%	53	32	61%	-	-	-	-	-	-
ADMINISTRIM BIZNESI	25	25	100 %	35	31	89%	70	18	26%	-	-	-	-	-	-
EKONOMIKS	33	30	91 %	30	30	100%	37	19	52%	-	-	-	-	-	-
INFORMATIKË EKONOMIKE	87	83	96%	65	62	96%	86	52	61%	-	-	-	-	-	-
MARKETING NDËRKOMBËTAR DHE MENAXHIM LOGJISTIK	35	31	89 %	23	22	96%	38	13	35%	-	-	-	-	-	-
FAKULTETI I DREJTËSISE DHE I SHKENCAVE SOCIALE	34	31	92 %	20	20	100%	44	17	39%	-	-	-	-	-	-
SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	14	14	100 %	20	20	100%	44	17	39%	-	-	-	-	-	-
DREJTËSI	20	17	85%	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI	508	476	94%	403	387	96%	662	275	42%	47	0	-	80	12	15%

CIKLI I DYTË			
UNIVERSITETI "EPOKA"			
Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	REGJISTRUAR	U DIPLOMUAN	PËRQINDJA E STUDENTËVE QË DIPLOMOHEN
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISË	143	49	34%
MSc- ARKITEKTURË	12	5	42%
MP- INXHINIERI KOMPJUTERIKE	12	7	58%
MSc- INXHINIERI KOMPJUTERIKE	47	4	9%
MSc - INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKIMI DIXHITAL	12	2	17%
MSc- INXHINIERI NDËRTIMI	33	10	30%
MP- INXHINIERI NDËRTIMI	7	6	85%
MP- MENAXHIM RISKU DHE MBROJTJE NDAJ ZJARRIT NË INXHINIERINË E NDËRTIMIT	20	15	75%
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE	216	42	19%
MP - FINANCË-BANKË	21	5	24%
MSc - FINANCË-BANKË	75	14	19%
MP - ADMINISTRIM BIZNESI	36	8	22%
MSc - ADMINISTRIM BIZNESI	62	12	19%

MSc – EKONOMIKS	9	2	22%
MP - MENAXHIM BIZNESI: PROFILI MENAXHIM ARSIMI	13	1	7%
FAKULTETI I DREJTËSISE DHE I SHKENCAVE SOCIALE	26	4	15%
MP- SHKENCA POLITIKE DHE MARREDHENIE NDERKOMBETARE	4	1	25%
MSc- SHKENCA POLITIKE DHE MARREDHENIE NDERKOMBETARE	22	3	14%
TOTALI	385	95	25%

CIKLI I TRETË		
UNIVERSITETI "EPOKA"		
Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	REGJISTRUAR	U DIPLOMUAN
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISË	4	1
PhD-ARKITEKTURË	1	0
PhD-INXHINIERI NDERTIMI	1	0
PhD-INXHINIERI KOMPJUTERIKE	2	1
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE	5	0
PHD-EKONOMIKS: PROFILI FINANCË-BANKË	0	0
PHD-EKONOMIKS: PROFILI EKONOMIKS	1	0
PHD-ADMINISTRIM BIZNESI	1	0
PHD-SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDERKOMBËTARE	3	0
TOTALI	9	1

2. Përqindjen e të punësuarve që kanë përfunduar këtë program studimi, nëse institucioni reklamon se ky program përgatit për një karrierë apo pozicion të caktuar;

Universiteti “EPOKA” i jep prioritet të diplomuarve të tij, duke mbajtur lidhjet me ta edhe pas diplomimit të tyre. Nëpërmjet mbështetjes që Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar u jep të diplomuarvë të Universitetit “EPOKA”, është bërë e mundur një përqindje e lartë e të punësuarvë menjëhërë pas diplomimit. Nga të dhënat e mbledhura nga të diplomuarit e Universitetit “EPOKA” për vitin akademik 2017-2018, rezulton se 92 % e të diplomuarvë të këtij viti aktualisht kanë filluar punë në profesionin e tyre ose janë dukë ndjekur studimet e tyre Master. Ndërsa 49 të diplomuar të vitit akademik 2017-2018 aktualisht ndjekin studimet e tyre Master ose punojnë jashtë Shqipërisë. Në tabelën e mëposhtme gjenden të dhënat e të diplomuarvë të vitit akademik 2017-2018 që ndodhen jashtë Shqipërisë:

Nr.	Shteti	Nr i Studentëve
1	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	6
2	Gjermani	18
3	Australi	1
4	Itali	6
5	Maqedoni	1
6	Sllovaki	1
7	Vietnam	3
8	Belgjikë	2
9	Danimarkë	2
10	Emiratet e Bashkuara Arabe (Dubai)	2
11	Kanada	1
12	Kosovë	1
13	Mbretëri e Bashkuar	4
14	Austri	2
15	Norvegji	1
16	Rrepublica Çeke	1
17	Austri	1
18	Lihtenshtajni	1
19	Francë	1
20	Azi	1
21	Suedi	1
22	Spanjë	1
23	Bruksel	1
	Gjithsej	59

Gjatë vitit akademik 2017-2018, janë diplomuar 280 studentë në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë në Arkitekturë dhe në programet Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Kompjuterike, Financë-Bankë, Financë-Bankë (Shqip), Informatikë Ekonomike, Ekonomiks, Administrim Biznesi, Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistikë, Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Dixhital si dhe Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. 53.8% e studentëve të diplomuar janë punësuar në sektorin privat, 16.6% punojnë në institucionet shtetërore dhe kompani prestigjioze në Shqipëri dhe 20.7% e të diplomuarve të këtij viti vazhdojnë studimet master ose punojnë jashtë shqipërisë.

Fakulteti/ Emërtimi i programit të studimit	Përqindja e të punësuarve
I. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë	
1. DIND- Arkitekturë	92.8%
2. BA- Inxhinieri Ndërtimi	84.2%
3. BA- Inxhinieri Kompjuterike	96.4%
4. BA- Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital	88.9%
II. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative	

1. BA- Financë-Bankë	88.2%
2. BA-Administrim Biznesi	92.2%
3. BA- Ekonomiks	95%
4. BA- Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	70.5%
5. BA-Informatikë Ekonomike	92.4%
6. BA- Financë-Bankë (Shqip)	81.2%
7. BA-Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik	86.6%
8- DIND në Drejtësi	Nuk nuk kemi të diplomuar pasi është program i hapur rishtazi.

3. Përqindjen e suksesit në provimet e shtetit kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar, si edhe përqindjen e profesionistëve që kanë përfunduar këtë program studimi dhe janë licencuar.

